


45
Vjet



Muzeu
Kombëtar
i Artit
Mesjetar





National Museum of Medieval Art

Compiled and published by The National Museum of Medieval Art

Kuratorë: Fjoralba Prifti; Pirro Thomo, Tatiana Vinjau Caca; Genti Proko

Foto / Arkiva: Ilir Terova

Adress:

Shëtitorja " Fan Noli" Korçë, Albania

tel: ++355 8250207

email: info@muzeumesjetar.gov.al

muzeumesjetar@hotmail.com

fb: Muzeu i Artit Mesjetar

Muzeu i Artit Mesjetar

Prodhurar nga: PromoPrint design center

ISBN

© Të gjitha të drejtat janë të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, 2025



Qëllimi i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar është mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore dhe e vlerave të paçmueshme të cilat përshkojnë historinë e vendit tonë, dhe t'i përhapim në brezat e ardhshëm, në të gjithë botën.

Ne besojmë se misioni ynë është të barazpeshojmë mbrojtjen dhe konservimin e veprave muzeale me ekspozimin dhe shfaqjen e tyre, në mënyrë që trashëgimia jonë kulturore, artistike, historia dhe tradita të kenë vetëm prosperitet.

Është gjithashtu dëshira e sinqertë për të krijuar mundësi për të gjitha moshat, të mësojnë më shumë rreth historisë sonë dhe të vlerësojnë, të ndihen krenarë mbi të shkuarën dhe vlerat artistike, kulturore që ne mbartim dhe transmetojmë.

MKAM, shërben si model prezantimi për shumë vizitorë të huaj, të cilët do të njohin më mirë dhe do të kuptojnë vendin tonë, në udhëtimin e vështirë shumëshkullor.

Në vazhdojmë ta konsiderojmë muzeun si një nga institucionet e trashëgimisë kulturore, me vlera të jashtëzakonshme, dhe më dinamiket në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe gjithashtu një vend në të cilin çdo vizitor frymëzohet dhe stimulohet.



Muzeu
Kombëtar
i Artit
Mesjetar



Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar u hap në vitin 1980 dhe përmban një nga koleksionet më të mëdha në botë përsa i përket Artit ikonografik, prej shek. 13-të deri në shek. 20-të.

Në vitin 1967, kur gjithçka që i përkiste fesë u shkatërrua, ku u ndalua besimi, ritet dhe mbi të gjitha u persekutuan predikuesit dhe besimtarët. Në emër të "Ateizmit komunist", u zëvendësua "besimi në fe dhe perëndi" me "besimin tek diktatori dhe partia", në këto kohë mjaft të vështira, në ikonoklastin më të egër, disa heronj, studiues dhe akademikë, si Theofan Popa, vendosën të shkojnë në çdo kishë, edhe në fshatrat më të largëta duke i ruajtur tempujt e besimit në emër të "Trashëgimisë Kulturore" dhe duke mbledhur çdo objekt të mundshëm religjioz. Këto objekte, pjesa më e madhe e të cilave ishin ikona, u vendosën që të shkonin në Korçë, dhe të ruheshin me emrin "Trashëgimi artistike dhe kulturore e popullit tonë mesjetar".



Vendimi nr. 123, dt. 14.5.1979, për Hapjen e Muzeut të Artit Mesjetar shqiptar në Korçë, i hapi rrugën muzeut "Me qëllim që të ruhen, të shfrytëzohen për studime, dhe të propagandohen traditat më të mira të popullit tonë, me propozim të Ministrisë së Kulturës, Kryesia e Këshillit të Ministrave, (Kryetar Mehmet Shehu), vendosi miratimin e hapjes së Muzeut të artit mesjetar në Korçë."

Pirro Thomo



Kisha e Burimit (Korçë)

"Valës shkatërruese nuk i shpëtoi dhe kisha Burimi Jetëdhënës e qytetit, e ndërtuar në vitet 1936-37, të cilës filluan t'i prishnin së pari kambanaret, për të pasuar më tej dhe me elementet e tjera. Nga kjo kishë ruhej si Monument Kulturor vetëm ikonostasi i saj. Shumë ide u hodhën për fatin e saj, disa në analogji me simotrat e saj, si Kisha e Madhe e Shkodrës që u kthye në sallë të mbyllur sporti, apo Xhamia Qendrore e Durrësit e kthyer në Shtëpi Rinie etj. Ishte surprizë e këndshme për të gjithë punonjësit dhe dashamirësit e Trashëgimisë Kulturorë udhëzimi i organeve më të larta të pushtetit të kohës që kjo ndërtesë të kthehej në Muze të Artit Mesjetar. Kjo i dha fund dhe dilemës se çdo të bëhej me ato mijëra objekte artistike që u grumbulluan në Korçë".



Në janar të vitit 1979, u caktua një program-pune dhe grupi i punës më qëllim që muzeu të përfundonte në muajin nëntor të po atij viti. Renditëshin emra të rëndësishëm në komisionin e krijuar si: Anastas Kondo, Andromaqi Gjergji, Dhorka Dhama, Luan Omari, Pirro Thomo, Hasan Nallbani, Skëder Anamali, etj.

Sipas grupeve të punës të krijuara, Muzeu u konceptua dhe u përshtat në ambientet e njëres prej katedraleve kryesore të qytetit të Korçës, atë të "Burimit Jetëdhënës".

"Ekspozita e Muzeut të Artit Mesjetar do të përbëhet prej një ambienti të madh në dy kate të ndara në salla dhe një korridor.

Në sallën e parë do të paraqiten materiale që i përkasin shekujve V – X. (relieve, kapitete, mozaikë, etj.)

Në sallat nr. 2, 3, 4, do të ekspozohen vepra të të shek. X- XV (afreske, ikona)

Në sallën nr. 5 (A), do të ekspozohet arti pasbizantin, shek. 16-të -17-të, që i përket periudhës antiosmane.

Në sallën nr. 5 (B), do të ekspozohen vepra të mjeshtërive të shek. XVIII – XIX.

Në sallën nr. 5 (C), do të ekspozohet piktura islamike e mjeshtërive anonimë, shek. XVIII –XIX.

Në sallat nr. 2, 3, 4, 5, do të ekspozohen objekte të ndryshmeqë përfaqësojnë gjini të kultivuara, edhe objekte të arteve të aplikuara, qëndisje, punime argjendi, tekstile, etj..

Në sallën nr. 6, do të ekspozohen gdhendje druri dhe guri.


Bashkëngjitur dhe lista e objekteve."



Pirro Thomo

"Zbatimi dhe aranzhimi i muzeut u krye nga Pirro Thomo me bashkëpunëtorë Kristofor Naslazin, Dhimitraq Çikën dhe me konsulentë të studiuesit dhe restauratorit Prof. Hasan Nallbani.

Nuk mund të kryhej me sukses kjo detyrë pa pjesëmarrjen me pasion të specialistëve duarartë korçarë të ndërmarrjeve të kohës, metalikes që prodhuan nga pistoletat e lampadarët e ndriçimit e deri te skarat metalike për vendosjen e ikonave, apo zdrukthëtarisë që prodhuan vitrinat, sfondet e ekspozimit të ikonave, bazamentet e objekteve të ekspozuara etj."




Në 26 Prill 1980, Muzeu i Artit Mesjetar hap dyert:

"Në Inaugurimi i Muzeut në Prill të 1980 dhe përshtypjet e vizitorëve të shumtë ndër vite ishte një shpërblim i merituar i mundit të të gjithë pjesëmarrësve për ngritjen e këtij muzeu të veçantë."

Pirro Thomo



Stafi i Muzeut në fillim të tij përbëhej fillimisht nga një grup prej 9 personash, të gjithë restauratorë / specialistë dhe drejtor Z. Avni Bilbili.







"Funksonimi i muzeut vazhdoi në të njëjtin format, deri në vitin 1991, kur me rikthimin e besimit fetar u kërkua që të rifunkciononte kisha e Burimit Jetëdhënës, madje u prish salla kryesore e ekspozimit dhe u kthye në faltore. Atëherë iu drejtuam Kryepeshkopit Anastas me kërkesën që të ruhej muzeu, duke e argumentuar me të vërtetat:

- Strehoi dhe ruajti një pasuri të madhe kulturore prej mbi 6 mijë objekteve
- I tregoi botës mbarë për Trashësinë e pasur Kulturore që krijoi populli ynë
- Mbajti gjallë besimin te besimtarët duke shpresuar se do të vijë dita t'i luten ikonave lirisht në kisha të lira, që deri atëherë i luteshin fshehurazi në muze.

Kërkesa jonë zuri vend dhe muzeu u rihap në sallën ngjitur të destinuar për ekspozita tematike dhe leksione, duke ruajtur njëkohësisht dhe ambientet e punës dhe fondin e pasur të ikonave."

Pirro Thomo



Në vitet 1991-1993 nr. i përgjithshëm i stafit arriti 22 persona dhe kryesisht ishin restauratorë/ specialistë dhe drejtorët në vazhdim ishin Franklin Xega, Lorenc Glozheni, Tatiana Vinjau Caca dhe prej vitit 2019, Fjoralba Prifti.
Restauratorë në vite: Kristofor Naslazi, Koço Ristani, Tatiana Caca, Kristaq Balli, Helga Theodhori, Sotirag Kuçal dhe Genti Proko, Romi Kallço, Genti Postoli (vivojnë aktualisht).



MKAM, prej vitit 2016, ndodhet në një ndërtesë bashkëkohore, me të gjitha parametrat e duhur, për një ekspozim dhe konservim ideal të këtyre vlerave të paçmueshme.

Arti Mesjetar reflektohet në harmoni me arkitekturën moderne. Mbizotërojnë ngjyrat bizantine, njëkohësisht dhe mistika e një bote tjetër, duke e sjellë eksperiencën në muze krejt të veçantë dhe shumë mbresëlënëse.

Aktualisht muzeu ka një fond të pasur prej 8265 objektesh, ku 6400 janë ikona, pjesa tjetër janë artefakte dhe objekte, guri, druri, metali, tekstile, etj.



Në hapje të muzeut në vitin 1980, ishte një fond i mbledhur prej rreth 6000 ikonash, të cilat ishin të parestauroara, 60 ikona erdhën nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë, të restauruara të cilat u ekspozuan në Muzeun e Artit Mesjetar.

Prej 1980-ës dhe deri tani, janë trajtuar mbi 3600 ikona, me problematika të ndryshme, janë konservuar dhe restauruar një numër i madh prej tyre, si dhe rreth 1000 objekte të tjera të fondit muzeal.





Në vitin 1993, ikona "Shën Maria Hodigritia" e atribuar mjeshtrit Onufri, e cila ishte e mbipikturuar në shek. e 19-të, u restaurua në Muzeun e Luvrit, dhe praktika e restaurimit të saj, e cila zgjati për një periudhë kohore prej dy vjetësh, ishte një përvojë e çmuar që u soll prej Z. Kristofor Naslazi, i cili asistoi në restaurimin e kësaj vepre.


- Në vitet 1999 – 2005 u zhvillua një nga projektet më të rëndësishme përsa i përket kualifikimit të stafit të restauratorëve, me Muzeun e Kulturës Bizantine në Selanik, dhe Qendrën Europiane e Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine, në Greqi. Gjatë programit u trajnuan 8 restauratorë dhe u restauruan dhe u studiuan me teknikat bashkëkohore 80 ikona të koleksionit të MKAM. Projekti u finalizua me çeljen e Ekspozitës "Ikona nga komuniteti orthodhoks i Shqipërisë" dhe dy botime prestigjioze: Katalogu i ekspozitës, i cili është një studim i thelluar shkencor, i realizuar nga studiuesja e mirënjohur Evgenia Drakopulu dhe Botimi i dytë "Manuali i Restaurimit të Ikonave". I pari botim i këtij lloji në Shqipëri. Në këtë botim janë përfshirë restaurimi i ikonave në përgjithësi dhe përshkruhet me detaje restaurimi i dhjetë veprave me problematika specifike realizuar me ndihmën e teknologjisë dhe analizave më të avancuara.





Laboratori i restaurimit dhe konsevimit, është përbërë prej specialistëve restauratorë, puna e të cilëve vazhdon të kryehet me përgjegjësi të plotë dhe të specializuar, pavarësisht periudhave të vështira në të cilat ka kaluar muzeu dhe vendi.

Me hapjen e muzeut në ndërtesën e ngritur enkas për këtë muze, në 2016-tën, objektet ruhen në ambiente ku garantohen të gjitha kushtet optimale të konservimit sipas të gjitha standardeve europiane të ruajtje së objekteve muzeale. Muzeu është i pajisur me një domë desifektimi e cila funksionon sipas një teknologjie bashkëkohore dhe shumë efikase.

Studioja e fotografisë digjitale, e cila na mundëson fotografimin e çdo objekti me rezolucion të lartë, të përshtatshëm për studime dhe botime në vazhdim.






Muzeu i Artit Mesjetar, me koleksionet , ekspozitat, aktivitetet e ndryshme, cilëson veten si një institucion dinamik , i cili vazhdon të rrisë dhe të vlerësojë më shumë jetën kulturore të komunitetit tonë, dhe jo vetëm, si dhe synon për vazhdimësinë, zhvillimin, dhe krijimin e mëtejshëm të kulturës dhe arteve, duke insistuar në njohjen deri në thelb të shoqërisë sonë, mbi trashëgiminë tonë kulturore dhe bërjen pjesë të pandashme jetese ndaj kulturës dhe artit.

MKAM, që në hapje të tij ka punuar, ekspozuar, promovuar, bashkëpunuar, jo vetëm si një nga institucionet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në vend, por edhe në bashkëpunime dhe ballafaqime me institucione homologe në rajon dhe në botë.

Në MKAM, veprat dhe artefaktet e ndryshme, janë restauruar, ekspozuar dhe studiuar duke përfunduar kështu vlerat që mbart, dhe duke i bërë të njohura botërisht.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar ka organizuar përgjatë 45 viteve shumë ekspozita të përkohshme, ka qenë pjesëmarrës në disa ekspozita të rëndësishme të çelura në vende të ndryshme të Europës, ka kryer sesione dhe konferenca shkencore, ka qenë pjesëmarrës në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke shpalosur vlerat e jashtëzakonshme të cilat mbart. Ka punuar thellësisht mbi edukimin dhe formimin e brezave të rinj, duke i dhënë përparësi njohjes së trashëgimisë kulturore. Ka lidhur marrëveshje me Universitetet të ndryshme mbi pjesëmarrjet shkencore, studimet apo dhe praktikat e punës, trajnimet, etj. Ka bashkëpunuar, hartuar dhe vazhdon me projekte me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit. Organizon aktivitete të ndryshme, me tematika të ndryshme të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në vizitueshmërinë dhe përhapjen e emrit të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar dhe koleksionit të tij të mrekullueshëm dhe cilësuar nga specialistët e huaj si i vetmi dhe më i madhi në botë.



Ekspozita jashtë vendit, në të cilat MKAM ka qenë bashkë- pjesëmarrës:

- 3 korrik – 7 Tetor, 1993 – Muzeu Kombëtar "Mesazhi Biblik Mark Shagal" Nice, Francë "Tresors d'art albanais, Icones byzantines et post-byzantines du XII au XIX siècle".
"Thesaret e Artit Shqiptar të ikonave byzantine dhe post- byzantine, të shek. XII deri në XIX.
- Prill – Korrik Mole Vanvitelliana, Ankona."Icône di Albania , Arte sacra dal XIV al XIX secolo, Albania tra la Mezzaluna e la Croce", "Ikona shqiptare, Arti i shenjtë prej shek. XIV deri në XIX, Shqipëria mes Kryqit dhe Gjysmëhënës.
- 15 shtator – 1 Dhjetor, 2002, Vicenza, Galeritë e pallatit Leoni Montanari, " Percorsi del Sacro, Icone dai musei Albanesi", "Udhët e Shenjta, Ikona nga Muzete e Shqipërisë".
- 19 Korrik -25 Tetor 2009, Keshtjella Svevo, Bari, Itali" Santi sul Adriatico" "Shenjtoret mbi Adriatik".
- Nëntor 2012 – 6 Janar, 2013, kompleksi i Viktorianëve, Roma, 24 Janar 2013 – 7 Prill 2013, Torino, Pallati Madarma "Tesori del patrimonio culturale Albanese", "Thesare të Trashëgimisë kulturore Shqiptare"
- 2018, UNESCO, Paris, Francë, " A window in the Albanian Medieval Art" "Një dritare në Artin Mesjetar Shqiptar".

Ekspozita jashtë vendit të MKAM:

- 14 Mars – 12 Qershor, 2006, Muzeu i Kulturës Bizantine, Selanik, Greqi, "Icons from the orthodox Communities of Albania, Museum of Byzantine Culture", "Ikona nga komuniteti Orthodhoks i Shqipërisë".
- 10 Tetor – 11 Nëntor, 2012, Moskë, Rusi; 19 Nëntor – 12 Dhjetor, 2012, Nixhni Novgorod "Albania, Icons from XIV – XVIII", " Shqipëria, Ikona shek. XIV – XVIII".
- 2026-2027 Chambéry, Francë, MKAM, ka parashikuar dhe në bashkëpunim me Muzeun e Arteve të Bukura në Chambéry dhe jo vetëm, çeljen e një ekspozite të përkohshme ku do të paraqitet koleksioni i MKAM, historia e krijimit, dhe domethënia e çdo objekti. Ekspozita është parashikuar të hyjë në Komitetin Shkencor të Ekspozitave në Francë, si dhe do të paraqitet si një nga eventet kulturore më të rëndësishme për sa i përket Francës.



Ekspozita të MKAM:

Prej vitit 2019, MKAM organizon çdo vit, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve dhe Ditës së Trashëgimisë Kulturore, dy ekspozita të përkohshme ku sjell ikona dhe objekte të sapo restauruara apo të cilat nuk janë shfaqur ende për publikun, duke evidentuar jo vetëm të një pjesëzë të pasurisë së tij nga fondet muzeale, por gjithashtu prezanton anën artistike. Sipas një përzgjedhje të caktuar, në bazë të temës dhe idesë, përzgjidhen objektet të cilat shfaqin më mirë qëllimin e ekspozitës. Qëllimi është jo vetëm promovimi i muzeut, shfaqja e kësaj pasurie të jashtëzakonshme që kemi ruajtur me fanatizëm prej shekujsh, por edhe nxjerrja në pah e vlerave artistike duke mësuar se si duhet të krenohemi me to.

~Ekspozita "Artgjend", (Qëllimi i kësaj ekspozite ishte jo vetëm shfaqja e disa prej objekteve të fundeve të pasura të MKAM, të cilat flenë prej shumë kohësh, por edhe të traditës sonë artizanale të të punuarit të metalit).

~Ekspozita "Restaurime", (Në Ditën e Trashëgimisë Kulturore, 29 Shtator 2020, përkujtuam jo vetëm hapjen e muzeut me vlera të papërsëritshme, por me anë të Ekspozitës "Restaurime" por u dhamë meritën e duhur atyre që punuan me dashuri të madhe për nxjerrjen në pah të këtyre vlerave).

~Ekspozita "Shën Maria", Në Maj 2021, u çel ekspozita me titull "Shën Mari", mbi figurën e Marias, në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar.

~"Dardharët", (Sipas, sesionit të parë shkencor, të vitit 1992 të organizuar po nga ana e MKAM, dhe një botimi dhe studimi të viti 2013, nga ana e dy ish specialistëve restoratorë, të viti 2013, Kristofor Naslazi dhe Kristaq Balli. Në MKAM ndodhen rreth 250 ikona, dhe rreth 24 autorë. MKAM, vlerëson me rigorozitet, studimin, hulumtimin, mbi veprat dhe autorët Dardharë, duke nxjerrë në pah çdo ditë e më shumë të dhëna dhe informacione të reja mbi to dhe autorët e tyre.)

~Veglat muzikore në ikonografinë bizantine, Në ekspozitën "Veglat muzikore në ikonografinë bizantine", e cila u hap në Maj të vitit 2022, janë përzgjedhur 13 vepra ikonografike, pjesë e fondit muzeal të MKAM, të cilat midis ilustrimit të skenës biblike kanë të përfshirë dhe instrumente muzikore.)

~Theofan Poca (Në 29 Shtator 2023, vlerësuam dhe përkujtuam një nga heronjtë e kohës diktatoriale, studiues dhe kërkues i Artit Bizantin, Theofan Poca.)

~Joan Pagëzori, Maj 2024, (Ekspozita paraqiste interpretimin e Johan Pagëzorit, në periudha të ndryshme dhe nag autorë të ndryshëm.)

Të gjitha ekspozitat janë shoqëruar nga sesione shkencore ku studiues, akademikë, njerëz të nderuar të Artit, Fesë dhe Shkencës kanë referuar mbi temat e përzgjedhura dhe kanë hedhur dritë mbi shumë të panjohura dhe kanë shtuar informacionin mbi objektet e fondit muzeal.



MKAM, ka mirëpritur çeljen e disa ekspozitave të përkohshme të sjella nga institucionet brenda dhe jashtë Shqipërisë, si:

- "Reliket e Shenjta të Ballkanit", një studim dhe ekspozim I Akademisë së Arteve dhe Shkencave mbi reliket e shenjta të Ballkanit dhe e sjellë në muze nga Ambasada e Bullgarisë në Shqipëri.
- "Natyra në Art, rasti i Qipros", një studim dhe përgatitja e ekspozitës, nga Shoqëria e Studimeve Bizantine, Qipro, dhe sjellë dhe mbështetur nga Qendra Europiane të Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine, Selanik, Greqi.
- "Ikonat e Dico Zografit, në MHK", Tiranë, një bashkëpunim midis MKAM dhe MHK, mbi ikonografin me origjinë nga Maqedonia e Veriut, Dico zografi.
- MKAM në bashkëpunim me Galerinë e Artit, Tiranë, me mbështetjen e MEKI dhe Bashkisë Tiranë, çelën ekspozitën "Një rrugëtim mbi Artin Hyjnor"





Bashkëpunime të tjera;

-MKAM ka nisur bashkëpunimin me Qendrën Europiane të Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine, Greqi mbi botimin e një katalogu prestigjioz shoqëruar edhe me studim mbi objektet dhe ikonat më të rëndësishme të muzeut.

- Projekti ACT4PRESPA Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është partner në bashkëpunim me IK Instituti dhe Muzeu Manastir, Organizata e Shoqërisë Civile për Zhvillimin e Turizmit Alternativ LJUBOJNO, Universiteti Aristoteli i Selanikut, Greqi, Ky projekt konsiston dhe do të japë kontribut në sfidat mjedisore, sociale, kulturore dhe ekonomike të lidhura ngushtë me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë dhe vlerave natyrore, të drejtat kulturore në Zonën e Liqenit të Prespës.

Vazhdon projekti në bashkëpunim me AADF " Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë. Për një qasje më të gjerë për të gjithë. "Mundësimi i studios fotografike me sistemin RTI, dhe rezolucion maksimal. Website I MKAM, është duke u realizuar nga MKAM në bashkëpunim me AADF.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar organizoi ekspozitën me titull:

"Ikonografia e Kishës Fjetja e Shën Marisë Lubonjë".

Një bashkëpunim midis Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave , Departamenti i Inxhinierise së Burimeve Minerare, i cili konsiston në studimin e ikonografisë së Kishës "Fjetja e Shën Marisë", restaurimin, konservimin dhe në fund ekspozimin si pjesë e projektit Hartografimi & Dokumentimi i Zonave Arkeologjike. Lubonjë-KORÇË,

8265 objekte janë të regjistruara në data bazën e muzeut, e cila ndihmon në lehtësimin e gjetjes së objektit, ruajtjen e tij si dhe informimin mbi të, njëkohësisht të jep mundësinë e përditësimit të vazhdueshëm të informacionit.

Ekspozimi digjital është tashmë një faktor shumë i rëndësishëm për shoqërinë dhe sigurisht që rrit ndjeshëm interesin dhe njohjen mbi MKAM, lehtësisht, në gjithë botën.

Mirëmbajtja dhe çuarja përpara e rritjes së formës dixhitale, sjell gjithmonë sfida të reja për tu përballur nga ana jonë.

-MKAM, mund të gjendet tashmë, në versionin 3D në internet,

-MKAM, mund të shkarkohet aplikacioni audioguidë, pa pagesë nga playstore dhe appstore, i vlefshëm në katër gjuhë, me rreth 80 pika interesi, dhe mund të kërkohet në emrin e muzeut ose duke përdorur kodin QR, njësoj si shumë muze të tjerë në botë.

-Ndërkohë, promovimi në rrjetet sociale, në formatet video ose foto, është gjithashtu një domosdoshmëri në promovimin e koleksionit dhe aktivitetit të muzeut përgjatë vitit.


Për herë të parë MKAM dhe koleksioni i tij erdhi në formë digjitale, në një ekspozitë emmersive, e cila ishte një risi dhe solli një tjetër formë këndvështrimi të ikonave, e mundësuar nga Bashkia Korçë dhe Ministria e Kulturës.





Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, punon për realizimin e strategjisë mbi trashëgiminë kulturore, artin, kulturën dhe vlerave që mbart. Gjithashtu, parashikon si objektivat e tij të ngushta në fushat e mëposhtme si: ruajtjen, konservimin, restaurimin, ekspozimin, edukimin, mirëmenaxhimin, vlerësimin, studimin dhe promovimin për kulturën dhe trashëgiminë kulturore si dhe synon stimulimin e interesit për kulturën dhe artet, përkundër dhe shumë sfida.

PRILL 2025



**Muzeu
Kombëtar
i Artit
Mesjetar**

Adresa: Shëtitorja "Fan Noli", 7001 Korçë, Shqipëri

Email: info@muzeumesjetar.gov.al

muzeumesjetar@hotmail.com

web: <http://www.muzeumesjetar.gov.al>